

Date 04.09.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i prokurimit: “Rikonstruksion i rruges Topojan”.**

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45233120-6** Punime ndërtimi për rrugë.

**Vlera e fondit limit: 136,350,696.55** (njqind e tridhjetë e gjashtë milion e treqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e nentëdhjetë e gjashtë presje pesëdhjetë e pese) Lek pa TVSH.

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 6 (gjashtë)** muaj kalendarik duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kukës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**a.** Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**b.** Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Sipas Shtojcës 7 të DST**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas *shtojcës 8 të DST*.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

*Shënim:* Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 b) dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 dhe kestin perkates per vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoritetet përkatëse sipas adresave të regjistruar ne QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kukës, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

### **Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

#### **1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **68,175,348.275** (gjashtëdhjetë e tetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzet e tetë pikë dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **272,701,393.1** (dyqind e shtatëdhjetë e dy milion e shtatëqind e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre pike një) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpërmendura e ben oferten te kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

## **1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
    - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
    - Kontratë Sipërmarrje;
    - Situacionin përfundimtar;
    - Aktin e kolaudimit;
    - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
  - b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
    - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
    - Kontrate Sipërmarrje;
    - Situacionin përfundimtar;
    - Aktin e kolaudimit;
    - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
    - Fatura tatimore perkatëse.
- 1.3** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.4** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

**a.** Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 68,175,348.275 (gjashtëdhjetë e tetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzet e tetë pikë dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**b.** Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlere monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 272,701,393.1 (dyqind e shtatëdhjetë e dy milion e shtatëqind e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre pike një) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve te sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

Gjithashtu referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

**Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlere monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të*

*shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e perqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

## **2. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

### **PUNIME TË PERGJITHSHME NDERTIMI**

- NP-1 A** Punime gërmimi në tokë.
- NP-4 C** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.
- NP-5 B** Punime nëntokësore, ura e vepra arti

**NP-12 A** Punime të inxhinierisë mjedisore

## **PUNIME SPECIALE NDERTIMI**

**NS - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve

**NS - 6 A** Sinjalistika rrugore jodriçuese

**NS - 7 A** Barriera dhe mbrojtje rrugore

**NS- 18 A** Punime topogjeodezike.

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjisllacionit në fuqi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Përcaktimi i kategorisë së licensave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton *"Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane."*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjisllacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve ne preventivin e hartuar nga projektuesi pasi aktivitetet kryesore qe do te beje Kontraktori per perfundimin me sukses te punimeve sipas kontrates ne kete objekt jane:

- PUNIME SHPYLLEZIMI
- NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME
- PUNIME DHEU
- ANALIZA TEKNIKE
- PUNIME SHTRESASH
- PUNIME BETONI E BETONARMEJE
- SINJALET DHE PAJISJET SHTESE. NGADALESUESIT E SHPEJTESISE
- TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA
- PUNIME GERMIMI
- ANALIZA JASHTE LISTE

Klasat janë përcaktuar referuar vendimit nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”

<b>Kategoria e Licenses</b>	<b>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>	<b>Vlera e punimeve në preventiv, sipas kategorisë përkatëse</b>
<b>NP-1 A</b> Punime germimi në tokë.	Ne preventiv parashikohen punime sipas preventivit ne kategorie 3:  Punime dheu  Germim shkambi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir 1000 m <sup>3</sup>	6,842,027.04 leke    0-20,000,000 leke



		<p>Ne kategorine 9:</p> <p>Punime germimi</p> <p>Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet 22817 m<sup>3</sup></p>	<p>Kategoria A</p> <p>Sipas klasifikimit te shoqerive ndertimore dhe nivelet per cdo kategori punimi</p>
<p><b>NP-4 C</b></p> <p>Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, metro, aeroportuale.</p> <p>tramvaj, pista</p>	<p><b>Ne kategorine 3:</b></p> <p>Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 3.0 km 23817 m<sup>3</sup></p> <p><b>Ne kategorine 4:</b></p> <p>Analiza teknike</p> <p>Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri 13566 m<sup>2</sup></p> <p>Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri 13566 m<sup>2</sup></p> <p><b>Ne kategorine 5:</b></p> <p>Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri 1600 m<sup>3</sup></p> <p>Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri 225 m<sup>2</sup></p> <p>Shtrese stabilizant t=15cm 17056 m<sup>2</sup></p> <p>Shtrese stabilizant t=10 cm 3590 m<sup>2</sup></p> <p><b>Ne kategorine 10:</b></p> <p>Analiza jashte liste:</p> <p>Shtrese çakelli mbeturine kave t=30cm,</p>	<p>195,102,830 leke</p> <p>51,000,000-100,000,000 leke</p> <p>Kategoria C</p> <p>Sipas klasifikimit te shoqerive ndertimore dhe nivelet per cdo kategori punimi</p>	

	perhapur e ngjeshur makineri 17056 m <sup>2</sup>	
<b>NP-5 B</b> Punime nëntokësore, ura e vepra arti	<p>Ne preventiv parashikohen punime sipas <b>kategorise 2:</b></p> <p>Mbushje me cakell pas mureve 1510 m<sup>3</sup></p> <p>Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni 97 m</p> <p>Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni 16 m</p> <p>Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni 6 m</p> <p>Tombino me tuba betoni Ø 1500, mbi shtrese betoni 6 m</p> <p>Ne kategorine 6:</p> <p>Punime betoni e beton arme:</p> <p>Struktura monolite betoni C 20/25 1754 m<sup>3</sup></p> <p>Struktura monolite betoni C 12/15 145 m<sup>3</sup></p>	<p>21,000,000-50,000,000 leke</p> <p>Kategoria B</p> <p>Sipas klasifikimit te shoqerive ndertimore dhe nivelet per cdo kategori punimi</p>
<b>NP-12 A</b> Punime të inxhinierisë mjedisore	<p>Ne preventiv parashikohen punime per shpyllezimin <b>ne kategorine 1:</b></p> <p>Preje e sistemim pemesh ø 21 ~ 40 cm 30 cope</p> <p>Prerje bime te vogla ø ~ 10cm 6800 cope</p> <p>Ne VNM paraprake parashikohen nder te tjera rehabilitimi i mjedisit të ndikuar dhe mundësia e</p>	<p>0-20,000,000 leke</p> <p>Kategoria A</p> <p>Sipas klasifikimit te shoqerive ndertimore dhe nivelet per cdo kategori punimi</p>

	kthimit të tij në gjendjen e mëparshme si dhe masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.	
NS - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve	Referuar projektit zbatuesi i punimeve është i ngarkuar për kryerjen e punimeve për piketimin e trupit të rrugës dhe nxjerrjen e kuotave.  Prishje struktura prej guri 60 m <sup>3</sup>  Prishje struktura prej betoni 25 m <sup>3</sup>	0-20,000,000 leke  Kategoria A  Sipas klasifikimit të shoqërive ndërtimore dhe nivelet për çdo kategori punimi
NS-6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese	Ne preventiv parashikohen punime sipas kategorisë 7:  Sinjalet dhe pajisjet shtese, ngadalesuesit e shpejtesise:  Vizime me boje bikomponente 900 m <sup>2</sup>  FV tabela të ndryshme rrugore D=60cm 61 cope	0-20,000,000 leke  Kategoria A  Sipas klasifikimit të shoqërive ndërtimore dhe nivelet për çdo kategori punimi
NS - 7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore	Ne preventiv parashikohen punime sipas kategorisë 8:  Te ndryshme, elektrike dhe sinjalistika  F.v. Pervijues modulare të kthesave (qyfte) 31 cope  F.V guardrail- N2 anesore me 2 valez. në 1 ane , W4 1474 ml	0-20,000,000 leke  Kategoria A  Sipas klasifikimit të shoqërive ndërtimore dhe nivelet për çdo kategori punimi
NS- 18 A Punime topogjeodezike.	Ne specifikime teknike parashikohet se zbatuesi i punimeve ben piketimin e aksit të rrugës dhe	0-20,000,000 leke  Kategoria A

	pergjigjet per caktimin e gjurmes fillestare dhe kuotave te rruges.	Sipas klasifikimit te shoqerive ndertimore dhe nivelet per cdo kategori punimi
--	---	--

I. Ne lidhje me kërkesën për disponueshmëri të kategorive të pikes NS-18, të licencës dhe nivelit të klasifikimit, Njesia ka marrë në konsideratë dhe thekson se referuar raportit teknik dhe specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, i gjithë përkrahimi do të kryhet nga Sipërmarresja.

Theksime se kërkesa për këto kategori dhe klase license është bërë dhe në përputhje me VKM Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", ku përcaktohet se:

N.S - 18 "Punime topogjeodezike", konsiderohet *zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Sa i përket klases "A" së kërkuar, theksojmë se kjo fushë specifike nuk shprehet në zera konkrete të preventivit, por është komplekse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat e zbatimit të projektit, nga momenti i marrjes në dorëzim të sheshit të ndërtimit deri në përfundimin e punimeve dhe dorëzimit pranë AK-së, të sheshit të ndërtimit, e për rrjedhojë kjo kërkesë është në proporcion me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e kontratës dhe kategoritë dhe klasat e licencës janë në proporcion me raportet teknike, specifikimet teknike objekt i kësaj kontrate si dhe konform përcaktimeve referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008

3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:
  - a) Librezë pune;
  - b) Kontratë pune e vlefshme;
  - c) Diplomë.

*(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm*

*gjate gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit).*

**Argumentimi:** *Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.*

*Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

4. Një punësim mesatar i të paktën 27 (njëzet e shtatë) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:
  - a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
  - b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore. (Kjo kerkese do të konsiderohet e përmbushur gjate fazes së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 27 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 6 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr.216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zerrat e punimeve në ndërtim”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpërndarje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit të mesiperm për numerin minimal të punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, raportit teknik, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier Mjedisi;
- 1 (një) inxhinier Gjeodet;

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Sa më sipër, duke marrë parasysh natyrën e punëve të objektit të prokurimit, ka perzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, të cilët janë të nevojshëm për realizimin e punimeve. Për më tepër duke qenë se këto punime janë të një rëndësie të vecantë dhe në të njëjtën kohë konsistojnë në nderhyrje mjedisore shikohet e nevojshme që të kerkohen specialist të fushave inxhinierike si: Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Mjedisi dhe Inxhinier Gjeodet.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik inxhinier Mjedisi, Njesia ka marrë në konsideratë dhe thekson se referuar raportit teknik dhe Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, Zbatuesi i Punimeve është ngarkuar me detyrime të përgjithshme në kujdesin për mjedisin. Metodatat e punës që duhet të aplikohen nga zbatuesi duhet të synojnë në minimizimin ose nëse është e mundur në ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit. Gjithashtu kerkohet që të ndermerren me rigorozitet masa mbrojtëse sa herë që të jete e nevojshme për të minimizuar ose për të ndaluar efektin negativ në mjedis.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik inxhinier Gjeodet, Njesia ka marrë në konsideratë dhe thekson se referuar raportit teknik dhe specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, i gjithë piketimi do të kryhet nga Sipermarresi.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar N.P –1A, N.P –4D, N.S – 6A, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NP12 A**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Mjedisit**.

Referuar preventivit te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NS 18 A**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinier Gjeodet**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

6. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë lëshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhen e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

#### Punonjës Staf Teknik

- Ing. Ndertimi 1 (nje)
- Teknik ndertimi 1 (nje)
- Topograf 1 (nje)
- Punonjes per punime ne rruge dhe asfaltim 10 (dhjete)
- Shofer 3 (tre)
- Manovrator 7 (shtate)

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë te lëshuara nga instuticione te licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN



PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

**Në lidhje me 1 (një) inxhinier ndërtimi:** prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**1 (një) teknik ndërtimi:** prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**1 (një) topograf:** prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**7 (shtatë) manovrator:** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, referuar volumeve të punës si dhe mjeteve të nevojshme për punët që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**3 (tre) shofer:** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, referuar volumeve të punës si dhe mjeteve të nevojshme për punët që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**2 (dy) automekanist:** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

**10 (dhjetë) punonjës për punime në rrugë dhe asfaltim:** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr.285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 6 (gjashtë) muaj.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:
  - a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015)
  - b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2018 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në

rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.

- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018.
- d) Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 39001-2012.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbyshje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 39001:2012 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS). Njësia e Prokurimit gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (ndërtim rruge) ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO 39001:2012.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 10 është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

9. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

<b>Nr</b>	<b>Lloji i makinerive</b>	<b>Pronësia</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
3	Eskavator me zinxhire	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
4	Eskavator me goma	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
5	Fadrome me goma	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
6	Minieskavator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
7	Autovinç deri 5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
8	Asfaltoshtruese	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
9	Grejder	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
10	Autobitumatriçe	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
11	Rrul Vibruës per ngjeshje asfalti deri ne 6 tov	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
12	Rrul Vibruës – me peshe jo me te vogel se 12 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
13	Betoniëre	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
14	Vibrator thellesie	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1

15	Autobot uji	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
16	Makineri per montim guardrail	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
17	Matrapik per eskavator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
18	Depozita uji deri 1000 liter	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
19	Sperkates boje per vijeze ne rruge,	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:
  - dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë);
  - leje qarkullimi;
  - çertifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme);
  - siguracion mjeti (i vlefshëm);
  - çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet:
  - kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi;
  - dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)
  - leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
  - siguracion mjeti (i vlefshëm);
  - çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- e. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim permbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr.216 datë 13.04.2023 “Për krijimin e dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

**10.** Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontrate bashkepunimi impiantet si më poshtë vijon:

- a. 1 (nje) Impiant prodhimi Inerte
- c. 1 (nje) Impiant prodhimi Asfalti
- c. 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të inerteve/asfaltit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vertetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit, është me qera ose kontrate bashkepunimi duhet të paraqitet kontrata e qerave/bashkëpunimit.

(KVO do të verifikojë nëpërmjet QKB nëse impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit është i pajisur me license 3.1.B, në rast të kundërt OE do të skualifikohet).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter vendoset bazuar në zërat e preventivit si dhe punimeve që do të realizohen dhe rëndësi se vecante të këtyre materialeve duke qenë se përbejnë pjesën më të konsiderueshme të preventivit të punimeve.

Autoriteti Kontraktues referuar zërave objekt i kontratës që po prokurohet ka kërkuar që impiantet e prodhimit të cilat mund të jenë në pronësi, me qera ose marrëveshje bashkepunimi të operatorit ekonomik që do të shpallet fitues si një garanci teknike që kontrata do të realizohet brenda afatave dhe në të gjithë kompleksitetin e zërave të punimeve

**Sqarim:** Autoriteti Kontraktor nuk kërkon asnjë dokumentacion nga subjekte të treta pasi verifikimi nëse impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit është i pajisur me license 3.1.B sipas kërkesave ligjore për mbrojtjen e mjedisit, do të bëhet nëpërmjet QKB-se.

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku parashikohet: “2. Paragrafi i parë, i pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”, sjellim ne vemendje se:

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

### **Njesia e prokurimit**